



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 219

Tiranë – E hënë, 21 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 137/2015 datë 17.12.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14419
Dekret i Presidentit nr. 9373, datë 18.12.2015	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 14419
Dekret i Presidentit nr. 9351, datë 11.12.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 14420
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Zhvillimit Urban, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shëndetësisë nr. 4, datë 9.12.2015	Për mënyrat e kryerjes së zhvarrosjes dhe zhvarrosjes murale të rasteve të veçanta..... 14420
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 611, datë 1.12.2015	Për procedurën dhe rregullat për dërgimin e rastit, nga Autoriteti Përgjegjës për Kufirin dhe Migracionin, te Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët..... 14440
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrië nr. 6451/8-A, datë 3.11.2015	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “arë” që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kV Rashbull-Golem-Kavajë”..... 14441
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 6495, datë 11.12.2015	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit, “Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit Himarë”..... 14443
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 4130/7, datë 14.12.2015	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të pronarëve që do të shpronësohen për shkak të “Rikonstruksionit të rrugës “Kinemaja e vjetër”, në Bashkinë e Patosit..... 14444

Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 4967/5, datë 14.12.2015	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të pronarëve që do të shpronësohen “Për zgjerimin e varrezave publike”, në Bashkinë e Peqinit.....	14444
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 5212/5, datë 14.12.2015	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të pronarëve që do të shpronësohen për shkak të “Zgjerimit të varrezave publike”, në Bashkinë e Skraparit.....	14445
	Ndreqje gabimi.....	14445



LIGJ
Nr. 137/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998,
“KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 177 të Kushtetutës, me propozimin e jo më pak se një të pestës së deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”.

Neni 2

Në nenin 45, paragraf 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Përfshihen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për

një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.”.

Neni 3

Në nenin 131, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.”.

Neni 4

Pas nenit 179 shtohet neni 179/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 179/1

1. Mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është fituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i zgjedhuri ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë të përjashtuara nga e drejta për t’u zgjedhur, sipas neneve 6/1 dhe 45, pika 3, të Kushtetutës.

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kuvendi, në përputhje me procedurën e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, miraton ligjin që përcakton kushtet dhe rregullat për garantimin e integritetit të organeve që zgjidhen, emërohen ose mbajnë funksione publike.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 17.12.2015

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 9373, datë 18.12.2015

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,



DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 137/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 137/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9351, datë 11.12.2015

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Carlo Fausto Bollino;
2. Kumrije Shaban Hamiti (Rugova).

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 4, datë 9.12.2015

PËR MËNYRAT E KRYERJES SË
ZHVARROSJES DHE ZHVARROSJES
MURALE TË RASTEVE TË VEÇANTA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e varrimit”, të ndryshuar dhe nenit 20, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 29.10.2014, “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë,

UDHËZOJNË:

I. Rastet e veçanta kur lejohet të kryhet zhvarrimi

1. Zhvarrimi, në raste të veçanta ose zhvarrimi i jashtëzakonshëm kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për qëllim:

- a) transferimi;
 - b) të interesit publik;
 - c) të ekspertizës mjekoligjore-kriminalistike.
2. Zhvarrimet nuk lejohen të kryhen:

a) kur kushtet klimaterike janë tepër të nxehta, zakonisht në muajt maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator, përveç varrezave që ndodhen në zona malore, në të cilat lejohet kryerja e këtyre operacioneve edhe në këta muaj;

b) në rastin e personave të vdekur nga sëmundjet infektive, të listuara në shtojcën 1 të këtij udhëzimi, përjashtuar rastet kur kanë kaluar dy vjet pas vdekjes dhe për të cilat, përfaqësuesi i strukturave lokale të shëndetit publik ka deklaruar, se zhvarrimi mund të bëhet pa pasoje për shëndetin publik, por duke respektuar masat e kontrollit dhe të parandalimit të infeksionit, të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Zhvarrimet që kryhen për qëllim të ekspertizës mjekoligjore-kriminalistike, pas urdhrit të lëshuar nga gjykata ose prokuroria nuk u përmbahen përcaktimeve të bëra në pikën 2/I të këtij udhëzimi.

II. Procedurat e kryerjes së zhvarrimit në raste të veçanta



1. Kërkesa për zhvarrosje kryhet nga:

a) gjyqtari ose prokurori, shoqëruar me urdhrin e lëshuar për zhvarrim para skadimit të afatit të zhvarrosjes duke argumentuar arsyen e kërkesës;

b) bashkëshorti/ja ose në mungesë, nga të afërmit të identifikuar në përputhje me Kodin Civil dhe të provuar me testament ose përfaqësim, shprehur në zyrën e gjendjes civile të njësisë bazë të qeverisjes vendore ku ka ndodhur vdekja apo të vendbanimit.

2. Kërkesa për zhvarrosje i drejtohet njësisë së qeverisjes vendore nën juridiksionin e të cilit është territori ku ndodhet varreza.

3. Njësia e qeverisjes vendore shqyrton kërkesën dhe ia kalon për miratim kryetarit ose këshillit bashkiak.

4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore pas miratimit lëshon autorizimin e zhvarrosjes.

5. Njësia e qeverisjes vendore brenda 5 ditëve nga data e miratimit të kërkesës për zhvarrosje bënë njoftimin me shkrim kërkuar të lejes së zhvarrosjes.

6. Shërbimi i varrezave njofton kërkuar për të cilin është miratuar zhvarrimi për të qenë prezent në momentin e zhvarrimit.

7. Procesi i zhvarrimit kryhet në prani të përfaqësuesit të strukturave lokale të shëndetit publik, të përfaqësuesit të autoriteteve të administrimit të varrezave, personave të ngarkuar me shërbimin e varrezave, përfaqësuesve të bashkisë, organeve të policisë vendore, dhe nëse kryhet zhvarrim i veçanta pas dy vjetësh nga vdekja dhe ata të prokurorisë.

8. Administruesi i varrezës, përcakton një person, i cili mbikëqyr procesin e zhvarrimit dhe garanton që i gjithë procesi të zhvillohet gjatë kohës që varreza është e mbyllur për publikun, ose në rastet kur kjo nuk mund të ndodhë, siguron që varri ku do të bëhet zhvarrimi të rrethohet me tendë ose material tjetër jotransparent, në mënyrë që publiku të mos ketë kontakt vizual me procesin.

9. Administruesi i varrezës, në koordinim dhe me miratim të strukturave lokale të shëndetit publik, përcaktojnë datën dhe orën e zhvarrimit dhe njoftojnë me shkrim përfaqësuesit sipas përcaktimeve të pikës 7/II të këtij udhëzimi, të cilët duhet të jenë të pranishëm në momentin e zhvarrimit.

10. Hapja e varrit kryhet nga personat përgjegjës të autorizuar nga autoriteti i administrimit të varrezës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

11. Zhvarrimet nga nëntoka, nuk kryhen pa kaluar minimalisht 2 orë nga rënia e shirave të rrëmbyeshëm.

12. Përfaqësuesit e strukturave lokale të shëndetit publik, marrin të dhënat për gjendjen e kufomës përpara varrimit nga regjistri i varrimit dhe përgatisin planin e masave higjieno-sanitare të nevojshme për procesin e zhvarrimit, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 2, pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

13. Përfaqësuesit e strukturave lokale të shëndetit publik monitorojnë procesin e zhvarrimit, në mënyrë që të mos shkaktohet asnjë risk për shëndetin publik, duke siguruar që:

a) personat, të cilët do të kryejnë procesin e zhvarrimit, duhet të pajisen me veshje mbrojtëse personale (PMP), me një përdorim, përfshirë edhe ekranin e fytyrës, që mbron sigurinë dhe shëndetin e tyre; lista e PMI-së tregohet në shtojcën 3 të këtij udhëzimi;

b) pas procesit të zhvarrimit, kufoma duhet të trajtohet me lëndë dezinfektuese, të cilat përfaqësuesi i autoritetit shëndetësor i gjykon të nevojshme; Lista e lëndëve dezinfektuese tregohet në shtojcën 4 të këtij udhëzimi;

c) kufoma e zhvarrosur vendoset në një mbështjellëse të mbyllur, jotransparente, që nuk lejon rrjedhjen e lëngjeve dhe shoqërohet me të dhënat identifikuese të kufomës;

d) pranë varrit të lirë duhet të sigurohet ujë i bollshëm, dhe lëndë të tjera pastruese/dezinfektuese, për t'u përdorur menjëherë pas përfundimit të procesit të zhvarrimit, nga personat të cilët do të trajtojnë kufomën e zhvarrosur;

e) kufoma apo mbetjet mortore, vendosen në arkivolin e ri; menjëherë pas procesit të zhvarrimit, varri i lirë dezinfektohet (i nënshtrohet procesit të dezinfektimit). Lista e lëndëve dezinfektuese dhe procedura e dezinfektimit jepen në shtojcën 4 të këtij udhëzimi.

14. Të gjitha mbetjet që rezultojnë nga aktiviteti i zhvarrimit të veçantë, përfshirë veshjet e punës, apo mjete të tjera të mbrojtjes personale me një përdorim, dhe që janë përdorur gjatë



zhvarrimin, duhet të trajtohen si mbetje të rrezikshme dhe të asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

15. Nëse përfaqësuesi i strukturave lokale të shëndetit publik konstaton, se trupi i kufomës nuk është vendosur në mënyrën e duhur në arkivol, mund të lejojë transferimin, vetëm pas vendosjes së përshtatshme në arkivol, në përputhje me rregulloren “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

16. Trupi i kufomës së zhvarrosur, duhet të rivarrosset ose të kremohet, brenda 48 orëve, në rast se nuk është përcaktuar ndryshe nga përfaqësuesi i strukturave lokale të shëndetit publik apo urdhri i gjykatës (përfaqësuesi i mjekësisë ligjore).

17. Kur rezulton se kufoma është në përfundim të procesit të mineralizimit, me miratim të familjarëve të të ndjerit, dhe në mungesë të tyre, të autoritetit që disponon kufomën, procedohet me rivarrimin në varret e eshtrave, në përputhje me kërkesat higjieno-sanitare, sipas planit të masave, të hartuar nga përfaqësuesit të shëndetit publik.

18. Në zbatim të pikës 20 të këtij udhëzimi, miratimi merret me shkrim nga autoriteti administrues i varrezave, para procesit të zhvarrimit dhe sigurohet kutia/ena ku do të vendosen eshtrat, si dhe masa të tjera në përputhje me rregulloren “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”, për rivarrimin në varret e eshtrave.

19. Veprimet që kryhen gjatë procesit të zhvarrimit dhe rivarrimit, përfshirë gjendjen e kufomës në çastin e hapjes së varrit, si dhe situatën fizike të varrit të ri ose atij ekzistues, dokumentohen në një proces verbal nga përfaqësuesi mbikëqyrës i autoritetit të administrimit të varrezës, ku kryhet zhvarrimi dhe rivarrimi. Procesverbalin duhet të firmoset nga të gjithë të pranishmit.

20. Në rastet kur rivarrimi i kufomës nuk bëhet në të njëjtën varrezë, procesverbalin mbahet përkatësisht nga të dyja autoritetet administrative të varrezave, si për procesin e zhvarrimit edhe për atë të rivarrimit dhe kopje të procesverbalit shkëmbehen mes tyre.

21. Zhvarrimi dhe rivarrimi shënohen në regjistrat përkatës të varrimeve sipas përcaktimeve në rregulloren “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

III. Procedura e zhvarrimit për transferim

1. Zhvarrimi për transferim kryhet pas dy vitesh nga vdekja dhe përpara planit të paracaktuar të rotacionit, me qëllim:

- a) transferimin në një varr tjetër në të njëjtën varrezë;
- b) transferimin në një varrezë tjetër;
- c) për kremim.

2. Kërkesa për zhvarrim për qëllime transferimi bëhet me shkrim nga bashkëshorti/ja ose në mungesë, nga të afërmit të identifikuar në përputhje me Kodin Civil dhe të provuar me testament ose përfaqësim, shprehur në zyrën e gjendjes civile të njësisë bazë të qeverisjes vendore ku ka ndodhur vdekja apo të vendbanimit, apo familjarët e të ndjerit, drejtuar autoritetit që administron varrezën.

3. Kërkesa i drejtohet:

a) autoritetit administrues të varrezës ku do të bëhet rivarrimi, në rastin kur kufoma do të rivarrosset në territorin administrativ ku dhe është zhvarrosur,

b) kryetarit të bashkisë që ka nën juridiksion territorin administrativ në rastin kur kufoma do të rivarrosset në territor administrativ të ndryshëm nga ai ku kryhet zhvarrimi.

4. Autoriteti që administron varrezën, brenda 5 ditëve pune, nga data e dorëzimit të kërkesës për transferim, kryen verifikimet paraprake te regjistri i varrimit dhe lëshon aprovimin për rivarrim.

5. Në rastin kur kufoma do të rivarrosset në territor administrativ të ndryshëm nga ai ku kryhet zhvarrimi autoriteti që administron varrezën brenda 5 ditëve pune nga data e aprovimit, i paraqet kryetarit të bashkisë kërkesën së bashku me aprovimin për rivarrim.

6. Kryetari i bashkisë, brenda 5 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës dhe e aprovimit nga autoriteti që administron varrezën, lëshon autorizimin për zhvarrim.

7. Autoriteti që administron varrezën para kryerjes së zhvarrimit njofton strukturat lokale të shëndetit publik për të marrë pjesë nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në momentin e zhvarrimit.

8. Në momentin e zhvarrimit përfaqësuesi i strukturave lokale të shëndetit publik lëshon deklaratën se:

- i) trupi i kufomës në arkivolin është i pacenuar;
- ii) transferimi i kufomës nga një varr, në tjetrin, nuk sjell pasoja për shëndetin publik.



9. Deklarata e lëshuar nga strukturat lokale të shëndetit publik mbahen në tri kopje; një kopje bëhet pjesë e dokumentacionit që shoqëron transferimin e kufomës në varrezën tjetër, një kopje mbahet nga autoriteti i varrezës ku kryhet zhvarrimi dhe një kopje e mban struktura lokale e shëndetit publik.

10. Transferimi i kufomës kryhet vetëm pasi autoriteti i shëndetit publik ka lëshuar deklaratën sipas pikës 8/III të këtij udhëzimi, e cila shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për zhvarrosjen importimin, eksportimin e eshtrave të njeriut dhe formulari i autorizimit, sipas shtojcës 5.

11. Varri i liruar nga mbetjet e arkivolit, pas dezinfektimit, mund të përdoret për varrime të reja, në përputhje me rregulloren “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

IV. Procedura e zhvarrimit për interes publik

1. Zhvarrimi për interes publik kryhet:

a) si nevojë e realizimit të investimeve publike/private në infrastrukturën publike kombëtare, në përputhje me dokumentet dhe aktet rregullatore në fuqi të planifikimit;

b) në zbatim të rishikimit të dokumenteve të planifikimit;

c) kur varreza përbën risk për shëndetin publik, i cili nuk mund të kontrollohet në asnjë mënyrë tjetër, përveçse me transferimin e saj.

2. Interesi publik miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit sipas dispozitave të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

3. Në rast se varreza përbën risk për sigurinë e jetës së popullatës apo për shëndetin publik, si: rrëshqitje dheu, tërmete, ndryshim i rrjedhës së ujërave nëntokësore etj., njësia e qeverisjes vendore pas verifikimeve dhe vlerësime të kryera, konstaton statusin e rrezikshmërisë dhe i përcjell këshillit bashkiak kërkesën për mbylljen e varrezës.

4. Në zbatim të interesit publik kombëtar, këshilli bashkiak miraton vendimin për mbylljen e varrezës, në territorin nën juridiksionin e tij, dhe njëkohësisht siguron funksionimin e një varreze të re, në përputhje me legjislacionin përkatës të planifikimit të territorit, dhe rregulloren për “Projektimin dhe ndërtimin e varrezave në Republikën e Shqipërisë”.

5. Këshilli bashkiak njofton nëpërmjet mjeteve të informimit publik, vendimin për mbylljen dhe

transferimin e varrezës, apo një pjesë të saj, për qëllime të interesit publik kombëtar.

6. Transferimi i varrezës nuk mund të kryhet pa kaluar 2 vjet nga mbyllja e saj.

V. Procedura e zhvarrimit për ekspertizë mjekoligjore-kriminalistike

1. Për qëllim të ekspertizës mjekoligjore-kriminalistike, prokuroria/gjykata urdhërojnë zhvarrimin e kufomave përpara afatit të përcaktuar për zhvarrimin e zakonshëm. Zhvarrimi për efekt të ekspertizës mjekoligjore-kriminalistike kryhet në çdo kohë pas varrimit. Procedurat e zhvarrimit dhe koha e rivarrimit drejtohet nga organi që ka lëshuar urdhrin përkatës.

2. Kryetari i bashkisë në territorin nën juridiksionin e të cilit është urdhëruar zhvarrimi, si dhe autoritetet e shërbimit dhe të administrimit të varrezës përkatëse, pasi njoftohen për urdhrin e nxjerrë nga autoritetet përgjegjëse, kanë detyrimin e zbatimit të tij.

3. Zhvarrimi kryhet në prani të grupit të mjekëve ligjorë, përfaqësuesve të gjykatës, prokurorisë, përfaqësuesit të autoriteteve të administrimit të varrezave dhe përfaqësuesit të strukturave lokale të shëndetit publik.

4. Me kryerjen e procesit të zhvarrimit, kufoma transportohet në sallat e autopsisë, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për transportin e kufomave.

5. Me përfundimin e ekspertizës mjekoligjore-kriminalistike dhe konform masave higjieno-sanitare, kufoma rivarroset në të njëjtin varr.

6. Në rastet e zhvarrimeve të shtetasve të huaj, procedura është e njëjtë si për shtetasit shqiptarë, ndërsa transportimi i trupit për në shtetin përkatës, kryhet përmes pajisjes me dokumentacionin si më poshtë:

a) certifikata e shkakut të vdekjes lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore;

b) leja e transportimit të trupit, që lejon kalimin e arkivolit nga territori i Republikës së Shqipërisë, lëshuar nga bashkia që ka nën juridiksion varrezën;

c) leja e transportimit të kufomës, që përjashton riskun e transmetimit të një sëmundjeje ngjitëse, lëshuar nga drejtoria e strukturave lokale të shëndetit publik;

d) kufoma duhet të vendoset në një arkivol hermetik me llamarinë dhe të plumbohet në prani të organeve të doganës, si dhe të një përfaqësuesi të ambasadës së vendit të destinacionit përkatës, për



këtë të pranishmit mbajnë një procesverbal.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqja

SHTOJCA 1: LISTA E SËMUNDEJEVE INFEKTIVE

Tabela 1. Lista e sëmundjeve infektive që transmetohen gjatë zhvarrimeve në periudhën më pak se 6 muaj nga momenti i vdekjes. Më pas këto sëmundje nuk mbartin rrezikshmëri.

Sëmundjet respiratore	Shkakëtarët	Sëmundjet infektive që transmetohen nga kontakti me lëkurën ose objektet e kontaminuar	Shkakëtarët
Tuberkulozi	Mycobakteri i tuberkulozit	Infeksion streptokoksik	Streptokoku invaziv i grupit A
Meningiti meningokoksik (me ose pa septicemi)	Bakteri neisseria meningitis	Infeksion stafilokoksik metilicilinozistetnt (MRSA)	Stafilokoku i artë
Meningiti jomeningokoksik	Bakterie, përfshirë Hemofilus influenza dhe viruse të tjera.		
Difteria	Corynobakter difteria		

Infeksione të tjera	Shkakëtarët
Ethja hemorragjike virale(transmetohet nga kontakti me gjakun dhe lëngjet trupore)	Viruse hemorragjike, Ebola, Lassa
Encefalopatia spongiforme (transmetohet nga cpimet aksidentale me mjetet e kontaminuar ose nga membranat mukoze)	Creutzfeld Jacob disease/variant CJD

Tabela 2. Për raste të vecanta të sëmundjeve infektive, mikroorganizmat e të cilave qëndrojnë për shumë kohë pas vdekjes

Agjenti infektiv/ Sëmundja	Mënyra e transmetimit	Mbijetesa e gjentit infektiv
Bacili Antraksit/ Antraksi	Aresolet nëpërmjet frymëmarrjes, kontakt direkt me lëkurën e dëmtuar, duart e kontaminuara	Identifikohet në formë sporesh
Virusi i varioles/ Lija	Inhalacion	Mbijeton në shumë kohë në ambjent shumë të thatë (deri në 13 vjet). Në ambiente mjedisore normale nuk jeton më shumë se 48 orë
clostridium tetani/ tetanozi	Hyn në organizëm nëpërmjet lëkurës së dëmtuar	Gjendet zakonisht në tokë
Leptospira iktero hemorragjike	Hyn në organizëm nëpërmjet lëkurës së dëmtuar	Infeksion i lidhur me brejtësit

Tabela 3. Masat universale të kontrollit të infeksionit

Masat e kontrollit gjatë gjithë kohës së punës	
Masat korrekte higjieno sanitare	Gjatë procesit të zhvarrimi
Higjena e duarve duhet të kryhet para cdo veprimi që nuk ka lidhje me zhvarrimin gjatë kohës së punës në territorin ku kryhet zhvarrimi	larja dhe dekontaminimi duhet të kryhen direkt pranë vendit të zhvarrimit
Mjetet mbrojtëse personale	komplet veshje , çizme, doreza, maskë e fytyrës, syze dhe/ose ekran mbrojtës për fytyrën
	Maskë e fytyrës (maska respiratore FFP2 dhe FFP3) apo dhe ekrani mbrojtës duhet të përdoret gjatë kryerjes së procesit të zhvarrosjes . Ky fakt do të mbrojë kundër inhalimit të mikroorganizmave infektive, por qëllimi kryesor i veshjes me këto pajisje është për të mbrojtur punëmarrësit nga mikropjesëza të tilla si pluhuri i drurit dhe plumbi.
	Pajisje respiratore mbrojtëse mund të nevojiten edhe kur punohet në ambjent të hapur, në qoftë se ka prova që një person sapo ka vdekur nga një sëmundje infektive e sistemit të frymëmarrjes, si tuberkulozi. Maska kirurgjike nuk sigurojnë mbrojtje të përshtatshme të frymëmarrjes. Punëmarrësit i duhet të veshin një maskë respiratore me valvul e pajisur me një filtër për grimcat në standardin P3 ose të vendosin një ekran mbrojtës për fytyrën me ventilim , për të kontrolluar ndonjë risk aerosoli.
	Maskat duhet të vishen vetëm për periudha relativisht të shkurtra kohë, deri në 4 orë. Maskat respiratore dhe ekranet mbrojtëse të fytyrës, duhet të mirëmbahen dhe të ruhen në mënyrë të sigurtë, kur nuk janë në përdorim.

**SHTOJCA 2. PLANI I VEPRIMIT PËR EPIDEMIOLOGUN**

Gjatë procesit të zhvarrimit, Epidemiologu ndjek planin e veprimeve:


- monitorimi i procesit të zhvarrimit
- Kontrolli dhe verifikimi për saktësinë e dokumentave që aprovojnë procesin e zhvarrimit
- sigurimi i hapjes së varrit të ri
- sigurimi që emri mbi pllakën e varrit të korrespondojë me emrin në kërkesë
- sigurimi i kohës së zhvarrimit i cili duhet të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, në mëngjes, për të siguruar privatësinë maksimale
- sigurimi i furnizimit me dezinfektuesit që duhet të përdoren për dezinfektimin e varrit dhe mbetjeve njerëzore, si dhe sigurimin e trajtimit të tyre me dezinfektues pas zhvarrimit.
- sigurimi i kryerjes së procesit të veshjes së rrobave mbrojtëse të gjithë punonjësive, duke përfshirë dorezat, kominoshet, maskat e fytyrës, etj
- sigurimi i respektimit ndaj personit të vdekur nga ana e familjarëve present.
- sigurimi që gjatë procesit të gjitha mbetjet dhe pjesë e arkivolit, rripi i trashë pëlhurë etj. të jenë vendosur në arkivolin e ri dhe mbetjet eshtrorë të rrezikshme të menaxhohen sipas protokollit të menaxhimit të mbetjeve infekte.

SHTOJCA 3. PAJISJET MBROJTËS PERSONALE DHE MËNYRA E PËRDORIMIT**Tabela 1.** Elementet përbërës të setit të Mjeteve Mbrojtëse Personale

Lista e mjeteve mbrojtëse personale	Sasia / nr
Veshje të brendëshme, për mbi rroba	
Kominoshe tyvek	
Përparëse e padepertueshme nga sekrecionet dhe lëngjet trupore	
Maskë respiratore FFP2, FFP3	
Syze mbrojtëse	
Ekran mbrojtës i fytyrës	
Doreza me një përdorim	
Cizme	
Mbrojtëse plastike/ hekuri e kokës	
Qese sigurie për materialet infekte/ biohasard	
Peceta me alcohol 70% me një përdorim	

HAPAT E VESHJES SE PAJISJEVE MBROJTESE PERSONALE (PMP)

1. Përdorimi i PMP është gjithnjë thelbësore në rastet kur jemi përpara një rasti të dyshuar apo rasti të konfirmuar të vdekjes nga një infeksion apo sëmundje infektive. Përgatit të gjithë elementet e PMP përpara fillimit të veshjes së tyre.
2. Veshja dhe zhveshja e tyre duhet të vëzhgohet nga një antar tjetër i grupit. Udhëzimet mbi veprimet korrekte të veshjes dhe zhveshjes së PMP duhet të shpërndahen në dhomën e veshje-zhveshjes.
3. Vendos setin e PMP-së në dhomën e veshje-zhveshjes




4. Vish çizmet rezistente ndaj shpimeve dhe depërtimit të lëngjeve dhe vendos mbrojtëset e këpucëve në se nuk kemi cizme të tilla.

Ose përdor këtë variantin e mëposhtëm



5. Vish përparësen mbi rroba.



6. Vendos maskën mbrojtëse të fytyrës



7. Vendos syzet mbrojtëse ose ekranin e fytyrës



ose




8. Nëse keni dëmtime/të cara në kokë ose i shmangeni spërkatjes me lëngje, në këtë rast mund të vendosni edhe kapuc mbrojtës.



9. Kryej procesin e larjes së duarve



9. Vish dorezat deri mbi mëngë*



10. Në rast se nuk dispononi përparësen e padepertueshme plastike dhe do të kryeni manipulime me kadavren ose do të keni kontakte me gjakun apo lëngje të tjera trupore, vendosni një përparëse kundra ujit mbi përparësen e butë.



KUR VISHNI PAISJET MBROJTESE PERSONALE (PMP)

- Shmangni prekjen dhe rregullimin e PMP-ve
- Zëvendësoni dorezat në rast carje apo dëmtimi
- Zëvendëso dorezat nga njëri pacient në tjetrin
- Kryeni procedurën e larjes së duarve përpara vendosjes së dorezave të reja

**Përdor dy palë doreza në se kryeni manipulime me kadavren ose në rast se keni kontakt me gjakun apo lëngje trupore. Përdor doreza të trasha gome për pastrimin e ambientit dhe menaxhimin e mbetjeve.*

HAPAT QË NDIQEN PËR HEQJEN E PMP-VE

1. Hiq përparësen plastike dhe hidhe atë në kontenierin e mbetjeve (në raast se duhet ripërdorur atëhere vendoseni atë në një kontenier me dezinfektant).



2. Nëse keni veshur mbrojtëse këpucësh, hiq ato ndërsa mbani ende veshur dorezat (nëse




ke të veshura çizme, shiko hapin 4)

3. Hiq përparësen së bashku me dorezat duke i rrotulluar nga brenda jashtë dhe hidhi në



kontenierin e sigurisë.

4. Nëse keni veshur çizme gome, hiqini ato (mënyra më ideale është përdorimi i paisjes për heqjen e tyre) pa i prekur me duar. Vendosini çizmet e hequra në kontenierin me dezinfektant.



5. Kryeni procesin e higjenës së duarve





Nëse keni vënë kapuc koke, është momenti për ta hequr atë (nga mbrapa kokës)

6. Hiq mbrojtëset e fytyrës:

6.a: Hiq syzet mbrojtëse nga pas përpara. Vendos syzet mbrojtëse në një kontenier të vecantë për ripastrim.

6.b: Hiq maskën mbrojtëse nga mbapa përpara. Kur e heq maskën, zgjidh fillimish lidhjen e poshtme dhe pastaj lidhjen e sipërme.



a)



b)

7. Kryej procedurën e larjes së duarve.



**SHTOJCA 4: LISTA E LËNDËVE DEZINFEKTUESE****PERDORIMI I SOLUCIONEVE DEZINFEKTANTE ME BAZE KLORI NE
ZHVARRIMIN E KUFOMAVE**

Nr	Llojet e Clorit	Kushte pastertie	Kushte Ndotje
1	Klor aktiv	0,1% (1g/l)	05% (5 g/l)
2	Solucion hipoklorit natriumi (klor aktiv 5 %)	20 ml/l	100 ml/l
3	Solucion hipoklorit kalciumi (klor aktiv 70 %)	1,4 g/l	7.0g/l
4	Pluhur dikloroizocianurat natriumi (klor aktiv 60 %)	1,7 gr/l	8,5g/l
5	Tablete dikloroizocianurat natriumi (klor aktiv 1,5g/tablet)	1 tablete /l	4 tableta/l
6	Kloramine (klor aktiv 25%)	20 g/l	20g/l

**MENYRA E KRYERJES SE HIGJENES SE DUARVE ME DEZINFEKTANT OSE LARJEN ME UJE.****KUR DUHET TE PERDORET DESINFEKTANTI I DUARVE?***Indikacione të përgjithshme:*

- Përpara dhe pas çdo kontakti direkt me procesin e zhvarrimit edhe kur janë veshur doreza.
- Menjëherë pas heqjes së dorezave.
- Përpara se të përdoret një procedurë invazive
- Pas prekjes së gjakut, lëngjeve trupore, sekrecioneve, ekskrecioneve, lëkurës së dëmtuar, edhe kur dorezat janë përdorur.
- Gjatë procesi të zhvarrimit, kur kalojmë nga një sipërfaqe e kontaminuar në një sipërfaqe të pastër.
- Pas kontaktit të objekteve që përdoren për zhvarrimin.

PERDORNI DESINFEKTANTIN E DUARVE PER NJE HIGJENE TE MIRE!**LANI DUART KUR JANE NE MENYRE TE DUKSHME TE NDOTURA!****Kohe zgjatja e procedures : 20-30 sekonda**

1a dhe 1b. Hidhni solucionin desinfektant në pellembe të dorës dhe përhapë atë në të gjithë sipërfaqen.

2. Ferkoni pjesët palmare të duarve me njëra tjetren.

3. Kaloni pjesën palmare të njërës dore mbi pjesën dorsale të dorës tjetër dhe kryqëzo gishtat me njëri tjetrin dhe ripërsërit procesin në të kundërt.

4. Ferkoni pjesët palmare të të dy duarve dhe kryqëzo serisht gishtat.

5. Kap duart me njëra tjetër nëpërmjet gishtërinjëve në opozitë me njëri tjetrin.

6. Ferkoni me njërën dorë gishtin e madh të dorës tjetër duke e ferkur në mënyrë rrethore dhe përsërit veprimin në dorën tjetër.

7. Ferkoni në mënyrë rrethore me gishtat e njërës dore pjesën palmare të dorës tjetër dhe përsërit të njëjtin veprim me dorën tjetër.

8. Kur duart janë të thara, ato janë të sigurta.

Teknika e larjes se duarve / koha optimale 40-60 sek



Lagni duart me ujë;



Aplikoni sasi të mjaftueshme të sapunit për të mbuluar tërë sipërfaqen e duarve;



Fërkoni duart shuplakë me shuplakë



Shuplaka e djathtë mbi dorzumin e majtë me gërshtëm të gishtërinjve dhe anasjelltas;



Shuplakë me shuplakë me gishtërinj të gërshtuar;



Pjesa e pasme e gishtërinjve në shuplakën përballë, me gishtërinjtë e bashkuar;



Fërkim rrotullues i gishtit të madh të dorës së majtë të mbërthyer me shuplakën e djathtë dhe anasjelltas;




Fërkim rrotullues para, mbrapa me gishtërinj të mbërthyer të dorës së djathtë në shuplakën e majtë dhe anasjelltas;




Shpërlani duart me ujë;



Tërnj duart mirë me një letër për një përdorim;



Përdorni letërën për ta mbyllur rubinetin;



Tani duart tuaja janë të sigurta.

**SHTOJCA 5: DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM PËR ZHVARROSJE IMPORTIMI / EKSPORTIMI I ESHTRAVE TË NJERIUT DHE FORMULARI I AUTORIZIMIT****(1) Dokumentet e nevojshme për zhvarrosjen**

(A) Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për zhvarrimin dhe eksportimin: certifikatë vdekje, letërnjoftimin/pasaportën, kerkese nga anëtar i familjes për importimin, Një kerkese nga ambasada ose sipërmarrësi që përfshin të gjitha të dhënat e gjeneraliteteve.

(I) Emri i te vdekurit _____

(Ii) Data e vdekjes _____

(Iii) Shkaku i vdekjes _____

(Iv) Vendi i vdekjes _____

(V) Vendi i varrimit _____

(Vi) Numer i kontaktit _____.

(1) Dokumentet e nevojshme për zhvarrosjen dhe eksportimin.

(A) Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për zhvarrimin dhe eksportimin: certifikatë vdekje, letërnjoftimin/pasaportën, kerkese nga anëtar i familjes për eksportimin, Një kerkese nga ambasada ose sipërmarrësi që përfshin të gjitha të dhënat e gjeneraliteteve.

(I) Emri i te vdekurit _____

(Ii) Data e vdekjes _____

(Iii) Shkaku i vdekjes _____

(Iv) Vendi i vdekjes _____

(V) Vendi i varrimit _____

(Vi) Numer i kontaktit _____.

(2) Dokumentet e nevojshme për zhvarrosjen dhe importimin:

(A) të dhënat personale duhet të përfshijë:

(I) Emri i të vdekurit _____

(Ii) Datën e vdekjes _____

(Iii) Vendlindjen e varrimit _____

(Iv) Vendi i rivarrimit (duke përfshirë numrat rendor të parces) _____

(V) Numri i kontaktit _____



(B) Certifikatën e vdekjes (Në qoftë se trupi është mbi 15 vjet në varr, certifikata e vdekjes nuk është e nevojshme)

(C) Kerkese për zhvarrosje

(D) Në qoftë se varret janë në tokë në pronësi private, është e nevojshme një aprovim nga pronari për të lejuar zhvarrosjen e trupit dhe miratimi I lejes nga autoriteti I pushteti vendor.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR IMPORTIMIN E ESHTRAVE (ME SEMUNDJE JO-INFEKTIVE)

(A) Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për zhvarrimin dhe eksportimin: certifikatë vdekje, letërnjoftimin/pasaportën, kerkesa nga anëtar i familjes per importimin, Një kerkese nga ambasada ose sipërmarrësi që përfshin te gjitha te dhenat e gjeneraliteteve.

(i) Emri i te vdekurit _____

(ii) Data e vdekjes _____

(iii) Shkaku i vdekjes _____

(iv) Vendi i vdekjes _____

(v) Vendi i varrimit _____

(vi) Numri i kontaktit _____

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR IMPORTIMIN E ESHTRAVE (ME SEMUNDJE INFEKTIVE)

(A) Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për zhvarrimin dhe eksportimin: certifikatë vdekje, letërnjoftimin/pasaportën, kerkese nga anëtar i familjes per importimin, Një kerkese nga ambasada ose sipërmarrësi që përfshin te dhenat e gjeneraliteteve.

(i) Emri i te vdekurit _____

(ii) Data e vdekjes _____

(iii) Shkaku i vdekjes _____

(iv) Vendi i vdekjes _____

(v) Vendi i varrimit _____

(vi) Numri i kontaktit _____

EKSPORTIMI I ESHTRAVE

(1) DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR EKSPORTIN E ESHTRAVE (ME SEMUNDJE JO-INFEKTIVE)

(A) Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për eksportimin e eshtrave:



Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për zhvarrimin dhe eksportimin: certifikatë vdekje, letërnjoftimin/pasaportën, kerkese nga anëtar i familjes për importimin, Një kerkese nga ambasada ose sipërmarrësi që përfshin të dhenat e gjeneraliteteve:

- (I) Emri i te vdekurit _____
- (II) Data e vdekjes _____
- (III) Shkaku i vdekjes _____
- (IV) Vendi i vdekjes _____
- (V) Vendi i varrimit _____
- (VI) Numri i kontaktit _____

(2) DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR EKSPORT (INFEKTIVE)

(A) Dokumentet e mëposhtme duhet të ofrohen për zhvarrimin dhe eksportimin: certifikatë vdekje, letërnjoftimin/pasaportën, kerkese nga anëtar i familjes për importimin, Një kerkese nga ambasada ose sipërmarrësi që përfshin të dhenat e gjeneraliteteve:

- (i) Emri i te vdekurit _____
- (ii) Data e vdekjes _____
- (iii) Shkaku i vdekjes _____
- (iv) Vendi i vdekjes _____
- (v) Vendi i varrimit _____
- (vi) Numri i kontaktit _____

FORMULAR - AUTORIZIM PËR IMPORT / EKSPORT TE ESHTRAVE NJERËZORE

Ky formular plotësohet për të kryer importimin / eksportimin e eshtrave të:

Emri i të ndjerit

Adresa

Vendi i vdekjes

Shkaku i vdekjes.....

Shteti dhe vendi i varrimit

Deklarata/ certificate që shtrat njerëzore janë infektive ose jo-infektive

Deklaroj se janë zbatuar të gjitha rregullat dhe legjislacioni përkatës, dhe se nuk ekziston asnjë arsye për ndonjë hetim të mëtejshëm ose ekzaminim që ky proces të mos kryhet.



Per këtë aresye jap leje për importimin / eksportimin e eshtrave te njeriut nga ne/ vendit të destinacionit me kusht që mbetjet njerëzore zhvarrosen dhe do të mbyllen në një enë hermetik dhe të vendosur në një arkivol te ri .

Informacion tjetër shtese.....

(Nënshkrimi)

(Përcaktimi)

(Data)

URDHËR

Nr. 611, datë 1.12.2015

PËR PROCEDURËN DHE RREGULLAT PËR DËRGIMIN E RASTIT, NGA AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN, TE AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR AZILIN DHE REFUGJATËT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autoriteti rajonal/vendor për kufirin dhe migracionin është struktura policore përgjegjëse për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes së të huajit, në pikat e kalimit kufitar ose brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti rajonal/vendor për kufirin dhe migracionin, në rast vështirësie për kryerjen e procesit të përzgjedhjes për azilkërkuesit, kërkon praninë e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

3. Në rast se në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, i huaji klasifikohet si azilkërkues, autoriteti rajonal/vendor për kufirin dhe migracionin, njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe autoritetin qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve.

4. Njoftimi mund të bëhet nëpërmjet këtyre formave të komunikimit:

- a) me telefon zyrtar;
- b) me postë elektronike zyrtare;
- c) me shkresë zyrtare.

5. Autoriteti rajonal/vendor për kufirin dhe

migracionin bashkërendon punën për transportin dhe dorëzimin e azilkërkuesit në Qendrën Pritëse për Azilkërkuesit, të caktuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kundrejt procesverbalit përkatës sipas modelit të miratuar me udhëzimin nr. 293, datë 4.6.2015, “Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”, i cili mbahet në dy kopje. Një kopje e procesverbalit i jepet punonjësit të Qendrës Pritëse për Azilkërkuesit, ndërsa kopja tjetër mbahet nga autoriteti rajonal/vendor për kufirin dhe migracionin. I gjithë informacioni hidhet në rubr

ikën përkatëse të Regjistrit Kombëtar për të Huajt, autoriteti përgjegjës, sipas fushës së përgjegjësisë, në zbatim të udhëzimit nr. 408/2, datë 11.2.2010, “Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar për të Huajt”.

6. Autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, i dërgohet një kopje e formularit të gjurmëve daktiloskopike dhe atij të përzgjedhjes, së bashku me një informacion për rastin, i cili mund të dërgohet edhe më postë elektronike zyrtare.

7. Kur gjatë procedurës së përzgjedhjes, konstatohen kushtet për ndalimin/arrestimin e të huajit azilkërkues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, autoriteti rajonal/vendor për kufirin dhe migracionin bën ndalimin/arrestimin e tij dhe ndjek procedurat e mëtejshme ligjore të parashikuara. Në vazhdim njoftohet autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve, i cili njofton autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

8. Në rast se azilkërkuesi paraqitet drejtpërsëdrejti pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, për regjistrimin e aplikimit



për azil, sipas germës “b”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, njofton autoritetin rajonal/vendor për kufirin dhe migracionin, i cili merr masat për marrjen e gjurmëve daktiloskopike dhe dërgimin e tyre, pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

9. Autoritet përgjegjës, të përcaktuara në këtë urdhër, që administrojnë të dhëna personale për të huajt që kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë, marrin masat e duhura organizative dhe teknike, për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, humbja aksidentale, aksesit ose përhapja të persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i këtyre të dhënave kryhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër përpunimi të jashtëligjshëm.

10. Me zbatimin e këtij urdhri ngarkohen autoritetet përgjegjëse sipas fushave të përgjegjësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

KËRKESË

Nr. 6451/8-a, datë 3.11.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “arë” që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kV Rashbull-Golem-Kavajë”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për personat sipas tabelës bashkëlidhur.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË
SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË
Koli Bele



LISTA E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 KV RASHBULL-GOLEM-KAVAJË
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë Arë

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim per shtyllë m ²	Vlera e Shpronësit me Lek/m ²	Vlera e Shpronësit me Lekë per shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Sasia Sip pronës m ²				
FSHATI RASHBULL												
						3215						
1	110	Tefik	Muharrem	Kalluli	3215	59/4	Arë	2835	17.4	227	3949.8	
2	1	Tefik	Muharrem	Kalluli	3215	59/4			82.92	227	18822.8	
3	2A	Fatmir		Fraholl	3215	59/3	Arë	300	51.84	227	11767.7	
4	2	Isuf	Kasem	Dervishi	3215	53/6	Arë	3500	34.33	227	7792.9	
		Pretendues				53/7	Arë	2500				
5	3	Pretendues			3215		Arë		96.04	227	21801.1	
6	4	Pretendues			3215		Arë		106.27	227	24123.3	
7	5	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
8	6	Pretendues			3215		Arë		77.33	227	17553.9	
9	7	Pretendues			3215		Arë		74.02	227	16802.5	
10	8	Pretendues			3215		Arë		62.5	227	14187.5	
11	9	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
FSHATI ARAPAJ												
						1031						
12	11	Muharrem	Ibrahim	Pajaziti	1031	126/14	Arë	1150	94.09	356	33496.0	
13	12	Pretendues			1031	192/7 192/8	Arë	8700	77.33	356	27529.5	
14	14	Besim	Kadri	Tropolini	1031	242/10	Arë	3760	42.82	356	15243.9	
15	15	Pretendues			1031		Arë		34.33	356	12221.5	
16	16	Pretendues			1031		Arë		41.46	356	14759.8	
FSHATI SHKALLNUR												
						3385						
17	17	Ramazan	Seit	Mucaj	3385	133/2	Arë	2500	94.09	227	21358.4	
18	18	Eqerem	Sabri	Muca	3385	133/5	Arë	7400	43.88	227	9960.8	
19	13 A	Mustafa	Jakup	Dervishi	3385	146/1-2	Arë	540	51.84	227	11767.7	
20	19	Bashkepronësi			3385	131/1	Arë	1350	58.32	227	13238.6	
21	20	Demir	Ramazan	Khafa	3385	264/16	Arë	4900	40.56	227	9207.1	
22	21	Pretendues			3385		Arë		34.33	227	7792.9	
	22	Bashkepronësi		Berberi	3385	433/5	Arë	2000	34.33	227	7792.9	
24	23	Pretendues			3385	490/4 491/1-10	Arë		34.33	227	7792.9	
25	24	Gezim		Copa	3385	535/8	Arë	2400	34.33	227	7792.9	
26	25	Robert		Myfolari	3385	565/20	Arë	7000	48.72	227	11059.4	
		Mynyre		Puja	3385	565/21	Arë	6000				

Nr.	Numri I shtyllës	Të dhëna për pronësinë						Sip. Shpronësim per shtyllë m²	Vlera e Shpronësit mit ne Lek/m2	Vlera e Shpronësitmit ne Leke per shtyllë	Shënime	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji I Pasurisë					Sasia Sip pronës m²
FSHATI KRYEMEDHENJ												
						2291						
27	26	Pretendues				2291	3/2 -	Arë	58.32	345	20121.7	
28	27	Xhemile	Ahmet	Sinarezi		2291	16/5/1	Arë	2300	34.33	345	11843.1
29	28	Bashkepronësi		Dervishi		2291	26/2	Arë	2140	34.33	345	11843.1
30	29	Azem	Islam	Dervishi		2291	70/6	Arë	1000	34.33		
		Fatmir	Islam	Dervishi		2291	70/7	Arë	1100		345	11843.1
31	30	Haxhi	Abdulla	Istrefi		2291	135/9	Arë	950	34.33	345	11843.1
32	31	Hamid Shtet	Reshat	Shirja		2291	169/2 196/7	Arë	1000	34.33	345	11843.1
33	32	Bashkepronësi		Shirja		2291	167/6	Arë	4600	77.33	345	26680.4
34	33	Pretendues				2291	215/3	Arë		34.33	345	11843.1
35	34	Petrit	Shefik	Tila		2291	215/7	Arë	10100	34.33	345	11843.1
36	36	Pretendues				2291		Arë		58.32	345	20121.7
37	37	Pretendues				2291	423/2 423/2	Arë		77.33	345	26680.4
38	38	Pretendues				2291	425/8	Arë		47.33	345	16330.4
FSHATI GOLEM												
						1791						
39	39	Pretendues				1791		Arë	112.36	345	38764.2	
40	40	Pretendues				1791		Arë	112.36	345	38764.2	
41	41	Pretendues				1791		Arë	40.56	345	13993.2	
42	31 A	Pretendues						Arë	73.96	345	25516.2	
43	42	Pretendues				1791		Arë	77.33	345	26678.9	
44	43	Pretendues				1791		Arë	34.33	345	11843.9	
FSHATI AGONAS												
						3961						
45	45	Lutfi	Masar	Zikullari		3961	8/1 -	Arë	10000	34.33	238	8170.5
FSHATI AGONAS												
						3961						
46	47	Pretendues				3961	172/4	Arë		77.33	238	18404.5
47	48	Besim	Beshir	Spanjoll		3961	35/4	Arë	5220	34.33	238	8170.5
48	49	Xhevat	Zeqir	Çopa		3961	70/4	Arë	12270	34.33	238	8170.5
49	50	Idajet	Vath	Rruga		3961	71/3	Arë	2000	34.33	238	8170.5
FSHATI KANAPARAJ												
						2071						
50	51	Pretendues		Spanjoll		2071	511/4	Arë		36.59	345	12623.6
51	52	Pretendues				2071	512/25	Arë		54.61	345	18840.5
52	53	Ibrahim	Shefqet	Kanapari		2071	512/20	Arë	12200	82.39	345	28424.6
53	54	Vili	Shefik	Kola		2071	750/14	Arë	3600	40.56		
		Selman	Shaqir	Spanjoll		2071	750/15	Arë	6400		345	13993.2
54	55	Bashkëpronësi		Çopa		2071	749/6	Arë	6000	132.25	345	45626.3



Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë						Sip. Shpronësim per shtyllë m ²	Vlera e Shpronësim mit ne Lek/m ²	Vlera e Shpronësimit ne Leke per shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë				
BASHKIA KAVAJË											
KAVAJË											
					8551						
55	56	Pretendues			8551	2/					ska informacion
56	57	Pretendues			8551	1/					ska informacion
57	58	Pretendues			8551	1/					ska informacion
58	59	Pretendues			8551	5/201					ska informacion
FSHATI GOLEM											
					1791						
59	62	Pretendues			1791	87	Arë	112.36	345	38764.2	
60	63	Pretendues			1791	88	Arë	58.32	345	20120.4	
61	64	Pretendues			1791	56	Arë	77.33	345	26678.9	
Sipërfaqe totale për shpronësim në m ²								3254.97			
Shuma totale në Lek për shpronësim										967956.8	

KËRKESË

Nr. 6495, datë 11.12.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit Himarë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Himarë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së

masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 43,906,145 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Gjon Radovani

TABELA E PRONAREVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PROJEKTIT “REHABILITIMI I SHËTITORES KRYESORE ANËS DETIT, HIMARË”

Nr	Mbiemri	Emri	Lloji i pasurisë	Nr. Hipotekore/Pasurie	Zona Kadastrale	Sip. objektit që shpronësohet	Vlera e objektit për shpronësimet në Lekë	Cmimi i objektit për njësi sipas titullit të shpronësimit	Cmimi i tokës së objektit për njësi sipas VKM.nr.514	Vlera e tokës për shpronësimet në Lekë	Vlera totale për shpronësimet «vlera e objektit - vlera e tokës në proporcion me sip.	Vendodhje
1	Beno	Edmond	Objekt-biznes	2386	1952	684 m ²	20880047.2	Ky cmim është llogaritur me koef.amortizimi 11% që nga viti 2004 pas rikonstruksionit			20880047.2	Spile,Himare
2	Gjicali	Fotaq	Objekt-banese	244	1952	176 m ²	7490736	42561 leke/m ²	4350 leke/m ²	765600	6725136	Spile,Himare
3	Doja	Ferdinant	Objekt-banese	459	1952	53.5 m ²	2277013.5	42561 leke/m ²	4350 leke/m ²	212477.92	2064535.58	Spile,Himare
4	Doja	Ferdinant	Objekt-banese	466	1952	37.8 m ²	1608805.8	42561 leke/m ²	4350 leke/m ²	184677.1	1424128.7	Spile,Himare
5	Gjoka	Jorgo	Objekt-banese	458	1952	152 m ²	6469272	42561 leke/m ²	4350 leke/m ²	346608	6122664	Spile,Himare
6	Gjoka	Kristo	Objekt-banese	457	1952	166 m ²	7065126	42561 leke/m ²	4350 leke/m ²	375492	6689634	Spile,Himare

SHUMA = 43906145.48

**KËRKESË****Nr. 4130/7, datë 14.12.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Patosit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve që do të shpronësohen për shkak të “Rikonstruksionit të rrugës “Kinemaja e vjetër”, në Bashkinë e

Patosit”, është 50 294 (pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të shpronësimit, që do të përdoret për rikonstruksionin e rrugës “Kinemaja e vjetër”, në Bashkinë e Patosit

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja m ² / truall	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek	Vërtetim pronësie
1	Yzedin Xhevat Fejzaj	2/8.	2890	50.7 m2	992	50 297	Konf. ZVRPP nr.2100/1 dt.29.04.2015
	Totali					50 297	

KËRKESË**Nr. 4967/5, datë 14.12.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Peqinit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, që do të shpronësohen “Për zgjerimin e varrezave publike”, në Bashkinë e Peqinit është 1

204 000 (një milion e dyqind e katër mijë) lekë.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të shpronësimit, që do të përdoret për “Zgjerimin e varrezave publike”, në Bashkinë e Peqinit

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. Dokumentit Hipotekor	Sipërfaqja m ² / tokë bujqësore	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Vule Xhaferr Maloku (Haramija)	232/2	3055	1171	800	301	240 800	Konf. ZVRPP nr.3843 dt.22.09.2015
2	Zyba Xhaferr Saranjezi (Haramija)	232/2	3055	1171	800	301	240 800	Konf. ZVRPP nr.3843 dt.22.09.2016
3	Myrteza Xhaferr Haramija	232/2	3055	1171	800	301	240 800	Konf. ZVRPP nr.3843 dt.22.09.2017
4	Et'hem Xhaferr Haramija	232/2	3055	1171	800	301	240 800	Konf. ZVRPP nr.3843 dt.22.09.2018
5	Sulejman Xhaferr Haramija	232/2	3055	1171	800	301	240 800	Konf. ZVRPP nr.3843 dt.22.09.2019
	Totali				4 000		1 204 000	

**KËRKESË****Nr. 5212/5, datë 14.12.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia e Skraparit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, që do të shpronësohen nga “Zgjerimi i varrezave publike”, në Bashkinë e Skraparit është 1 592 000

(një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të shpronësimit, që do të përdoret për “Zgjerimin e varrezave publike”, në Bashkinë e Skraparit

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja m ² truall	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Selam Teki Koprencka	55/50	1420	1000 m ²	796	796 000	Certifikatë për vërtetim pronësie
2	Hektor Teki Koprencka	55/48	1420	1000 m ²	796	796 000	Certifikatë për vërtetim pronësie
Totali						1 592 000	

NDREQJE GABIMI

Në aktin normativ nr.2, datë 11.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr.213, në faqen nr.14023, në nenin 2, nëndarja

“Detyrimet e prapambetura”, korrigjohet shifra

ishte: “... 8 500 ...”

bëhet: “ ... 18 500 ... ”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë